



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr. 31/18
Datë: 4 MAJ 2018

Mbështetur në neni 4, 28, 35, 36, 37, 38 dhe neni 54, paragrafi (2) me nën paragrafët 2.1, dhe 2.2 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare Nr. 88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare në bazë informatave që posedon dhe dyshimeve për marrëveshje të ndaluara, kurdisje të ofertave në tenderët publik si dhe praktika të bashkërenduara të ndërmarrjeve në tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë “Furnizim me Citostatik nga Lista Esenciale e barnave për produktin Imatinib Mesylate 400mg, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën **04 MAJ 2018** merr këtë:

KONKLuzion

I. Për fillimin e procedurës hetimore ndaj ndërmarrjeve:

- a. **NTSH “REDONI H M”** - Nr. Regj. biznesit: [REDAKTUAR] Adresa: Rr. Behar Begolli PN, Prishtinë.
- b. **“EXCLUSIVE CORPORATION” SHPK** - Nr. Regj. biznesit: [REDAKTUAR] Adresa: Rr. Hilmi Rakovica, Nr. 43, Prishtinë.
- c. **“EXCLUSIVE” SHPK** - Nr. Regj. biznesit: [REDAKTUAR] Adresa: Rr, Abdullah Tahiri PN, Prishtinë.

II. Për shkak të dyshimeve për marrëveshje të ndaluar ose praktikave të bashkërenduara sipas nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, në proceset tenderuese të Ministrisë së Shëndetësisë, për barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg.

Hetimet do të zhvillohen për:

1. Kontratën me Ref: 206/011//098/111 – Lloti 6.
2. Kontrata me Ref: 206/011//098/111 – Lloti 6 – me Aneks Kontratën për kontratat publike kornizë.
3. Kontrata me Ref: 206/16/003/111 – Lloti 10
4. Draft Kontrata (*e pa nënshkruar - në procedurë ankimi në OSHP*) me Ref: 206/017/030/111 – Lloti 17.
5. Si dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg.

- III. Autoriteti i Konkurrencës kërkon nga ndërmarrjet e lartcekura që në afat prej **15 ditësh** nga dita e pranimit të këtij konkluzioni t'i sjellin në zyrat e Autoritetit këto dokumente:
- a. DUD-at duke përfshirë faturat importuese dhe pagesën për barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - b. Librin e blerjes importues dhe vendore për barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - c. Librin e shitjeve për barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - d. Faturat e shitjeve për barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - e. Faturat e blerjeve për barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - f. Ofertat tenderuese në autoritetet kontraktuese për barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - g. Kontratat dhe Aneks kontratat e tenderëve publik të fituar për barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - h. Faturat furnizuese ndaj institucioneve për barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - i. Kopjen e pagesave të cilën e ka ekzekutuar autoriteti kontraktues për barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg ndaj kompanive prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - j. Marrëveshjet e bashkëpunimit në mes konkurrentëve, ose format e bashkëpunimit prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - k. Deklaratat vjetore prej vitit 2014 deri më 2017.
 - l. TM1, TM2 TM3, TM4 – prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - m. Kontratat e të punësuarve prej vitit 2014 deri më 30.04.2018.
 - n. Listën e pagave të të punësuarve nga 2014 deri më 30.04.2018.
 - o. Komunikimet elektronike ndërmjet ndërmarrjeve nën hetim, si dhe me Departamentin e Prokurimit të MSH-së, adresë email-i, numër fax-i, komunikimet postare, komunikimet me sms, komunikimet në rrjete sociale, viber, whatsapp, facebook, etj – të printuara.
 - p. Stoqet e produkteve në fund vit prej 2014 deri më 31.12.2017.

A R S Y E T I M

Pas shqetësimeve të publikut dhe thirrjes së Ministrit të MSH-së, Autoriteti me datë 30.10.2017 ka kontaktuar zyrtarët kompetent të MSH-së lidhur me këtë çështje. Shqetësimet e tyre ishin për shkak se kanë vërejtur se çmimet e ofruara në kontratë nga ofertuesi dhe çmimi referent i tregut për këtë lloj bari ka dallime të mëdha dhe si të tillë Ministria nuk e ka proceduar për nënshkrim kontratën me Ref: 206/017/030/111 - Lloti 17. Operatori ekonomik fitues i kësaj kontrate është ankuar në të gjitha institucionet që rregullojnë fushën e Prokurimit Publik, siç janë KRPP dhe OSHP. Gjithashtu shqetësimet e zyrtarëve të MSH-së janë në mos ka marrëveshje të ndaluar për kufizim të konkurrencës në procedurat e prokurimit të kësaj kontrate.

Autoriteti sipas detyrës zyrtare ka filluar monitorimin e këtij rasti dhe ka marrë informatat e nevojshme nga institucionet relevante lidhur me rastin e po ashtu inspektorët e Autoritetit kanë hulumtuar tregun përkatës në regjionin e Prishtinës për të vërtetuar çmimet e tregut për bari IMAKREBIN - Imatinib Mesylate 400mg. Në kuadër të kësaj janë inspektuar shumica e barnatoreve të Prishtinës. Gjatë kësaj vizite kemi hasur se shumica e këtyre barnatoreve nuk e posedojnë këtë lloj bari por kemi gjetur tek një barnatore e cila e posedonte në stokun e saj dhe e shiste me çmimin prej 9.66 € për copë, gjithashtu dallimi i çmimit doganor importues me çmimin ofertues në tenderët publik është pothuajse më shumë se 400%.

Tregu përkatës apo relevant

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2011, bazuar në analizën e këtij rasti, si treg gjeografik konsiderohet **territori i Republikës së Kosovës.**

Tregu i produktit është:

Tregu Farmaceutik në vend përkatësisht produkti apo bari IMAKREBIN - Imatinib Mesylate 400mg. Ky bari bënë pjesë në grupin e Citostatikëve në Listën e barnave esenciale, i cili përcaktohet si IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg në specifikacionet e tenderëve të Ministrisë së Shëndetësisë, si më poshtë:

1. **Ref: 206/011//098/111 – Lloti 6;**
2. **Ref: 206/011//098/111 – Lloti 6 – si dhe Aneks Kontrata për kontratat publike kornizë;**
3. **Ref: 206/16/003/111 – Lloti 10;**
4. **Ref: 206/017/030/111 – Lloti 17.**

Përshkrimi i rastit: Ministria e Shëndetësisë ndër vite sipas nevojave dhe kërkesave ka shpallur tender me procedurë të hapur për furnizim me barna nga Lista Esenciale, në të cilët tender ka qenë i përcaktuar në Lote të ndryshme bari IMAKREBIN - Imatinib Mesylate 400mg. Ky bari shpërndahet falas nga barnatorja qendrore e SHSKUK-së dhe përdoret nga pacientët që vuajnë nga sëmundje të rënda kanceroze dhe leukemisë. Kërkesat ndër vite (nga 2015 deri në vitin 2017) të MSH-së sipas evidencës sonë, të siguruara nga MSH, SHSKUK, Dogana e Kosovës, duket se janë të ndryshme. Po ashtu edhe çmimet e importuara për këtë bari janë të ndryshme, nga prodhues e vende të ndryshme. Sipas evidencës Furnizimi me këtë lloj bari ka filluar me kontratën publike kornizë të MSH-së në vitin 2012 dhe ka vazhduar deri më tetor 2017.

Nëse bëjmë krahasimin e çmimeve të importit/shitje me pakicë dhe çmimeve të kontraktuara në tenderët publik vërehet se ekziston dyshimi se kompanitë kanë ofruar çmim jo real të shitjes, krahasuar në çmimet doganore të importuara. Dyshimet e AKK-së janë mbi atë se ndërmarrjet kanë arritur Marrëveshje e ndaluar ndërmjet operatorëve ekonomik ose janë koordinuar për të bashkërenduar aktivitetet e tyre të cilët në mënyrë të fshehtë bien dakord për rritjen e çmimeve për blerësit në këtë rast “autoritetet kontraktuese” të cilët kanë pasur nevojë të sigurojnë produktet nëpërmjet procedurave të prokurimit publik për Listën Esenciale të barnave. Sipas evidencës sonë në ofertat tenderuese ka sinjale se këta ndërmarrje kanë aplikuar metodën apo parimin e **rotacionit në kurdisje** të tenderëve në të qenurit fitues.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni për fillimin e procedurës hetimore nuk është e lejuar ankesa e as padia për inicimin e konfliktit administrativ.

Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
KOMISIONI**

(_____)
Valon PRESTRESHI
Kryetar

(_____)
Ahmet KRASNIQI
Zv. Kryetar

(_____)
Fatime HAZIRI
Anëtare

(_____)
Muhamed KRASNIQI
Anëtarë

(_____)
Shaqir MORINA
Anëtarë

Me këtë **KONKLUZION** të njoftohen:

- *Arhiva*
- *Publikohet në web faqen e Autoritetit*
- *Ndërmarrjet*
- *Ministria e Shëndetësisë*